

LIGJ
Nr.7714, datë 27.5.1993

PËR DISA NDRYSHIME NË DEKRETIN NR.7393, DATË 12.6.1990 "PËR LËSHIMIN E PASAPORTAVE PËR JASHTË SHTETIT DHE DHËNIEN E VIZAVE"

Në mbështetje të nenit 28, pika 4 të ligjit nr.7491, datë 29.4.1991 "Për dispozitat kryesore kushtetuese", me propozim të Kryetarit të Këshillit të Ministrave,

KUVENDI POPULLOR
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Neni 1

Në nenin 17 shtohet një paragraf me këtë përmbajtje:

"Shtetasve egjiptianë, sauditë, të Emirateve të Bashkuara, Kuvajtit, Omanit, Katarit dhe Bahreinit, të cilët e vërtetojnë këtë me dokumente, t'u jepet viza në pikat tona kufitare. Taksa e vizës të merret në bazë të reciprocitetit.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi menjëherë.

Shpallur me dekretin nr.554, datë 5.6.1993 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Sali Berisha